



DARDANIA



SHOQATA E PËLLUMBAVE AKROBATIKË TË KOSOVËS NË ZVICËR

RREGULLORJA

E

SHOQATËS SË PËLLUMBAVE AKROBATIKË (rrotullues) TË
KOSOVËS NË ZVICËR

SHPAKZ



"DARDANIA"



DARDANIA



SHOQATA E PËLLUMBAVE AKROBATIKË TË KOSOVËS NË ZVICËR

1. Rregullorja e SHPAKZ

- Parimi bazë në rregulloren e SHPAKZ-së është që anëtarët e kryesisë së Shoqatës janë të detyruar të trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjithë kultivuesit apo garuesit e pëllumbave, pa marrë parasysh nga kombësia, feja apo nga cili rajon vijnë ata.
- Kryesia i cakton për çdo garë anëtarët e grupit vlerësues për vlerësimin e pëllumbave.
- Për vlerësimin e gjatësisë së rrotullimit të pëllumbave do të caktohen vetëm ata kultivues dhe garues me përvojë, të cilët janë dëshmuar për korrektësi vlerësimi.

2. Mënyra e paraqitjes për gara

- Terminin e paraqitjes për pjesëmarrje në gara, kultivuesit mund ta bëjnë 2 javë para fillimit të garave.
 - Kultivuesi i cili i paraqet pëllumbat për të garuar është i detyruar që të bëjë të njohur numrat e unazave në këmbët e pëllumbave.
 - Nëse njëri nga kultivuesit i paraqet 3 pëllumba për të garuar dhe e përfundon garën me një ose me dy pëllumba, atëherë ai kultivues ka të drejtë të marrë pjesë në gara të mëtutjeshme pas tre javësh me atë pëllumb, i cili nuk është paraqitur në garën e mëparshme.
- Afati për t'u paraqitur në garë do të jetë deri 5 ditë para mbajtjes së garave, duke përfshirë rastet e veçanta dhe të arsyetuara deri 3 ditë para mbajtjes së garave, si p.sh. një garues anulon pjesëmarrjen 4 ditë para garave, atëherë i jepet mundësia një tjetri që të shfrytëzojë këtë boshllëk për t'u paraqitur për gara edhe deri 3 ditë para mbajtjes së tyre.
- Kultivuesit dhe garuesit duhet të kenë sjellje të mira dhe korrekte ndaj të gjithë kultivuesve dhe garuesve të tjerë, pa marrë parasysh funksionin apo detyrat brenda shoqatës.
- Kultivuesit dhe garuesit janë të detyruar t'i respektojnë mendimet dhe vlerësimet e vlerësuesve të shoqatës çfarëdo qofshin ato, të drejta ose jo.

E drejta e ankesës

- Secili kultivues ose garues gëzon të drejtën e ankesës nëse mendon se i është bërë ndonjë e pa drejtë ndaj tij ose pëllumbave të cilët ai i paraqet. Ankesat duhet të paraqiten me shkrim dhe të argumentuara me fakte.
- Kryesia e SHPAKZ është e detyruar që të shqyrtojë çdo ankesë të paraqitur.
- Çdo ankesë duhet të shqyrtohet dhe në afatin e përcaktuar me rregullore duhet të njoftohet me shkrim personi lidhur me vendimin e marrë.

3. Anulimi i garës

- Anulimin e një gare kultivuesi ose garuesi duhet ta bëjë në afatin prej 5 ditësh, por më së voni deri 3 ditë para mbajtjes së garave.
- Për mospërfilljen e afateve të përcaktuara për anulimin e garave, kultivuesit dhe garuesit duhet të llogarisin në gjobën prej CHF 100.--, gjobë e cila duhet t'i paguhet kryesisë së shoqatës.
- Gjoha nuk mund të ngrihet në raste të veçanta të anulimit të garave, siç janë rastet e rënda familjare, raste të vdekjes ose të ngjashme.



DARDANIA



SHOQATA E PËLLUMBAVE AKROBATIKË TË KOSOVËS NË ZVICËR

4. Gjoha ndaj kultivuesit apo garuesit

- a) Gjoha është e paraparë për arsye që kultivuesi i cili nuk paraqitet në gara pa arsye dhe kështu pengohen shumë kultivues të tjerë të mërin pjesë në gara.
- b) Kultivuesi apo garuesi mund të gjobitet nëse pëllumbi i tij nuk arrin gjatësinë e rrotullimit 50 metra.
- c) Kultivuesi apo garuesi do të gjobitet nëse nuk e kanë stërvitur sa duhet pëllumbin para garës, kështu që pëllumbi i tij fluturon larg kotecit dhe fillon me rrotullimin kokë më vete, ndërsa figura, kualiteti dhe rrotullimi nuk dallohen mirë dhe kështu krijohet dyshimi për personat që janë të caktuar për ndarjen e drejtësisë gjatë garës.
- d) Garuesi do të gjobitet nëse pëllumbi i tij fluturon në lartësi nën 50 metra dhe fillon të rrotullohet duke u përplasur për tokë me ç'rast pëson lëndime dhe nuk është në gjendje të vazhdojë më tutje garën.
- e) Kultivuesi nuk do gjobitet nëse pëllumbi i tij gjatë garës është i ndjekur ose i frikësuar tej mase nga shpendët grabitqarë.
- f) Kultivuesi nuk gjobitet nëse në moment gjatë garës ndryshojnë kushtet klimatike, duke ndërprerë zhvillimin e garës.
- g) Nëse dy kultivues të pëllumbave i ruajnë pëllumbat bashkë në një kotec dhe paraqesin pëllumbat e tyre për gara të dy me nga një pëllumb veç e veç, do të gjobitet vetëm ai kultivues apo garues pëllumbi i të cilit nuk do t'i përmbushë kërkesat e garës.

5. Rregullat për pëllumbat garues

- a) Të gjithë ata pëllumba që garojnë duhet të kenë unazat e tyre të ndonjë shoqate ose klubi në këmbë, edhe pse pëllumbat mund të kenë edhe unazat me emër dhe adresë të pronarit. Por numri i unazës duhet të jetë me numër rendor.
 1. Lejohen të marrin pjesë në garë të gjithë ata pëllumba të cilët kanë unazën e kultivuesit me emër dhe adresë por pa numër. Kjo unazë duhet të jen 7 mm ose 7.5 mm. Kultivuesi e ka për detyrë që unazat t'i pastrojë para se të fillojë gara dhe që numri i unazës të jetë i lexueshëm.
 2. Nëse ndonjë kultivues do që të garojë me pëllumbat të cilët nuk bartin numër në unazë por që janë të pajisur me adresë të plotë të garuesit apo të kultivuesit do t'i lejohet të garojë, por, nga tufa e kotecit do garojnë sipas ngjyrave vetëm nga një pëllumb. Domethënë për secilën ngjyrë ka të drejtë gare një pëllumb.
- b) Ne i njohim dhe i respektojmë të gjitha unazat e pëllumbave në botë, por madhësia e unazës së pëllumbave të cilët garojnë në SHPAKZ duhet të jenë 7 mm ose 7.5 mm.
- c) Nuk kanë të drejtë pjesëmarrje në gara pëllumbat të cilët verifikohen se kanë unaza të dyshimta apo të falsifikuara në këmbë.
- d) Kultivuesi apo garuesi nuk kanë të drejtë të lëshojnë pëllumbin për fluturim pa i dhënë shenjë ata të cilët e drejtojnë garën.



DARDANIA



SHOQATA E PËLLUMBAVE AKROBATIKË TË KOSOVËS NË ZVICËR

6. Rregullat rreth fluturimit të pëllumbit

Pëllumbi zakonisht lëshohet për të fluturuar nga koteci por nëse ndodhë që kultivuesi don ta lëshojë pëllumbin më larg se koteci apo ndonjë kodër është e lejueshme

- a) Pëllumbi gëzon të drejtën për të fluturuar 3 herë për një garë:
 1. Fluturimi i parë ka kohën e caktuar 30 - minuta
 2. Fluturimi i dytë ka për shfrytëzim 15 -minuta
 3. Fluturimi i tretë ka për shfrytëzim 15 -minuta
- b) Fluturimi është i përfunduar kur pëllumbi i bën tre rathë fluturimi pa marrë parasysh lartësinë e fluturimit dhe ndalet në çfarëdo objekti afër apo larg kotecit ose në tokë.
- c) Kultivuesi gjatë garës ka të drejtë që ta shfrytëzojë edhe kohën e dy fluturimeve tjera nëse e sheh se pëllumbit të tij i nevojiten minuta shtesë. Në raste të tilla koha e shfrytëzuar e fluturimeve tjera nuk mund të përdoret më.
- d) Nga tre fluturime notohet fluturimi më i suksesshëm.
- e) Shfrytëzimi i kohës llogaritet që nga momenti kur pëllumbi fillon fluturimin.
- f) Nëse pëllumbi rrotullohet larg kotecit ndërsa figura nuk duket e qartë atëherë largësia nga koteci nuk luan ndonjë rol nëse dy vlerësues e vlerësojnë rrotullimin të suksesshëm, kështu që pëllumbi mund të kalojë garën.
- g) Në rast se rrotullimi është i dyshimtë dhe nuk duket qartë, derisa dy vlerësues e vlerësojnë të pasuksesshëm, atëherë pëllumbi nuk mund të kalojë garën.
 - Lidhur me nenin **f** dhe **g** duhet të caktohet një zonë e kufizuar deri në sa metra larg kotecit lejohet të bëjë rrotullimin një pëllumb;
 - për pëllumbat akrobatikë (rrotullues) të Kosovës përcaktohet një kufizim të një largësie të rrotullimit prej 155 – 170 m; (Lidhur me këtë shih skemën e cila përcakton zonën der sa metra larg kotecit lejohet të bëjë rrotullimin një pëllumb).
 - tek largësia e rrotullimit rol të rëndësishëm luan qartësia dhe pastërtia e rrotullimit.

7. Kualiteti i figurës dhe rrotullimit të pëllumbat rrotullues

- a) Pëllumbi akrobatik (rrotullues) i Kosovës bën disa lloje të figurave gjatë rrotullimit. Sipas kualitetit dhe figurave që paraqesin pëllumbat gjatë rrotullimit bëhet edhe vlerësimi dhe notimi i tyre.

1. **Nota 3:** Rrotullimi në formë topi dhe shumë ngadalë
2. **Nota 3:** Rrotullimi me flatra të hapura dhe të mbajtur në rreth
3. **Nota 3:** Rrotullimi në formën e konit shumë ngadalë
4. **Nota 3:** Rrotullimi në formë shishe dhe shumë ngadalë

1. **Nota 4:** Rrotullimi në formë topi dhe shpejtësi gjysmë ngadalë
2. **Nota 4:** Rrotullimi në formë koni dhe shpejtësi gjysmë ngadalë
3. **Nota 4:** Rrotullimi në formë shishe dhe me shpejtësi gjysmë ngadalë

1. **Nota 5:** Rrotullimi në formë topi dhe me një shpejtësi të mirë
2. **Nota 5:** Rrotullimi në formë shishe dhe me një shpejtësi të mirë
3. **Nota 5:** Rrotullimi në formë koni dhe me një shpejtësi të mirë



DARDANIA



SHOQATA E PËLLUMBAVE AKROBATIKË TË KOSOVËS NË ZVICËR

1. **Nota 6:** Rrotullimi në formë topi dhe me shpejtësi shumë të shpejtë
 2. **Nota 6:** Rrotullimi në formë të zgjatur dhe me flatra formon figurën e yllit pesërremësh dhe ka shpejtësi të madhe gjatë rrotullimit
- b) Vlerësimi i kualitetit të rrotullimit behët në bazë të notave të vlerësuesve.
- nota 1 dhe 2 hyjnë në një grup dhe janë të përafërta me njëra tjetrën. Këto nota janë të pamjaftueshme për të kaluar garën.
 - nota 3 dhe 4 do të jenë të përafërta dhe bëhen për vlerësimin e rrotullimeve mesatarisht të suksesshme.
 - nota 5 dhe 6 do të jenë të përafërta dhe bëhen për vlerësimet e rrotullimeve më të suksesshmet.
- c) Nëse një pëllumb bën rrotullimin p.sh. në lartësinë 70 m dhe merr notën 5 ndërsa pëllumbi tjetër për rrotullimin në lartësinë 70 m merr notën 6, atëherë në këso rasti vendosë nota më e lartë.

Rang lista varianti 1		Rang lista varanti 2	
1.	p.sh. 70 m me notë 6	1.	1. P' sh 75 m me notë 5
2.	p.sh. 70 m me notë 5	2.	2. P' sh 70 m me notë 6
3	p.sh. 70 m me notë 4	3.	3. P' sh 75 m me notë 3
4.	p.sh. 70 m me notë 3	4.	4. P' sh 70 m me notë 4

- d) Nëse kultivuesit apo garuesit dhe shoqata nuk duan të përcaktohen për variantet e lartpërmendura, atëherë mund të zgjedhin variantin e përshtatshëm me marrëveshje - vetëm rrethrotullimin, gjë e cila duhet përcaktuar para fillimit të garave.

8. Llojet e rrotullimeve dhe klasifikimi i tyre

1. **Rrotullimi** në formë të zgjatur dhe me flatra në formën e figurës së yllit pesërremësh dhe që ka shpejtësi të rreptë gjatë rrotullimit
2. **Rrotullimi** në formë topi (top hendbolli) dhe me shpejtës shumë të madhe
3. **Rrotullim** në formë shishe dhe me shpejtës shumë të madhe
4. **Rrotullim** në formë koni dhe me shpejtës të madhe
5. **Rrotullimi** me flatra të hapura dhe të mbajtura në rreth dhe shumë ngadalë
6. **Rrotullim** me flatra gjysmë të hapura të mbajtur në rreth dhe ngadalë
7. **Rrotullim** në formën e konit shumë ngadalë
8. **Rrotullim** në formë shishe dhe shumë ngadalë
9. **Rrotullim** në formë topi dhe me shpejtësi gjysmë ngadalë
10. **Rrotullim** në formë koni dhe shpejtësi gjysmë ngadalë
11. **Rrotullim** në formë shishe dhe me shpejtësi gjysmë ngadalë
12. **Rrotullim** në formë topi por që ka shpejtësi të mirë
13. **Rrotullim** në formë shishe dhe që ka shpejtësi të mirë
14. **Rrotullim** në formë e konit por që ka shpejtësi të mirë



DARDANIA



SHOQATA E PËLLUMBAVE AKROBATIKË TË KOSOVËS NË ZVICËR

9. Nënrrrotullimet

Nënrrrotullimet nuk luajnë ndonjë rol të veçantë tek pëllumbat të cilët garojnë sepse dallimi i tyre është fare i vogël nga rrotullimi të cilit ai i përket.

10. Ndarja e rrotullimeve në Kategori A dhe B

Ndarja e të gjitha rrotullimeve në kategori do të bëjë punën shumë më të lehtë dhe më efikase për të gjitha strukturat dhe për garuesit apo kultivuesit e pëllumbave akrobatikë rrotullues të Kosovës.

1. Kategoria A

Në këtë kategori bëjnë pjesë katër rrotullime me kualitet të lart. Për nga kualiteti rrotullimet kanë kualitet të njëjtë mirëpo kanë dallim sa i përket figurës gjatë rrotullimit. Ky dallim nuk i pengon që këto 4 rrotullime të jenë së bashku në **Kategorinë A**.

15. **Rrotullimi** në formë të zgjatur dhe me flatra në formën e figurës së yllit pesërremësh dhe që ka shpejtësi të madhe gjatë rrotullimit
16. **Rrotullimi** në formë topi (top hendbolli) dhe me shpejtësi shumë të madhe
17. **Rrotullimi** në formë shishe dhe me shpejtës shumë të madhe
18. **Rrotullimi** në formë koni dhe me shpejtës të madhe
Kësaj kategorie i bashkangjiten edhe 4 nënrrrotullime:
19. **Rrotullimi** i gjerë në formë disku dhe me një shpejtësi shumë të madhe gjatë rrotullimit
20. **Rrotullimi** në formën e një trëndafili dhe me një shpejtësi shumë të madhe
21. **Rrotullimi** që fillon me një figurë të rrotullimit dhe gradualisht vjen duke e ndryshuar ose duke e ngushtuar formën e figurës së rrotullimit dhe pëllumbi fillon të zgjatet
22. **Rrotullimi** në formë të shishes me shpejtësi të madhe dhe figura e rrotullimit bëhet në cepat e krahëve

2. Kategoria B

Në këtë kategori hyjnë të gjitha ato lloje të rrotullimit që për nga kualiteti janë përafërsisht të njëjta dhe që dallojnë për nga figura gjatë rrotullimit që paraqesin pëllumbat gjatë rrotullimit.

1. **Rrotullimi** me flatra të hapura dhe të mbajtura në rreth dhe shumë ngadalë
2. **Rrotullimi** me flatra gjysmë të hapura të mbajtura në rreth dhe ngadalë
3. **Rrotullimi** në formën e konit shumë ngadalë
4. **Rrotullimi** në formë shishe dhe shumë ngadalë
5. **Rrotullimi** në formë topi dhe me shpejtësi gjysmë ngadalë
6. **Rrotullimi** në formë koni dhe shpejtësi gjysmë ngadalë
7. **Rrotullimi** në formë shishe dhe me shpejtësi gjysmë ngadalë
8. **Rrotullimi** në formë topi por që ka shpejtësi të mirë
9. **Rrotullimi** në formë shishe dhe që ka shpejtësi të mirë
10. **Rrotullimi** në formë e konit por që ka shpejtësi të mirë



DARDANIA



SHOQATA E PËLLUMBAVE AKROBATIKË TË KOSOVËS NË ZVICËR

Kryesia e shoqatës e ka për detyrë që t'i njoftojë garuesit dhe anëtarët e shoqatës para se të fillojë sezoni i garave se për cilin variant të rrotullimit është përcaktuar kjo kryesi:

1. Varianti vetëm rrethrotullim
2. Varianti rrotullim i vlerësuar në bazë të notave
3. Varianti ndarjes së rrotullimeve përmes kategorisë A dhe B

11. Hapja dhe Mbyllja e Garave

- a) Sezona e garave për pëllumbat akrobatikë (rrotullues) të Kosovës mbahet e hapur nga 3 marsi dhe përfundon me 21 dhjetor.
- b) Nëse gjatë kohës jashtë sezonës së garave mbanë mot i mirë dhe i përshtatshëm për gara, atëherë kultivuesit ose garuesit mund të paraqiten për garim.

Për t'u arritur kjo që u përmend më lartë nevojitet miratimi dhe koordinimi në përputhje dhe harmoni të plotë me kryesinë e shoqatës dhe kultivuesit.

12. Pëllumbat të cilët garojnë

- a) Çdo pëllumbi i lejohet të marrë pjesë në gara 3 herë gjatë sezonës së garave. Për çdo pjesëmarrje në gara pëllumbat duhet të regjistrohen dhe nuk mund të bëhet anulimi i fluturimit pasi të të kenë hyrë në garë.
- b) Nëse një pëllumb gjatë garës arrin rezultat të mirë, p.sh. 110 m dhe ka fluturuar një herë, ai mund të mos i shfrytëzojë 2 fluturimet tjera.
- c) Nëse pëllumbi tjetër i shfrytëzon 2 fluturime dhe arrin rezultat 2 x 110, atëherë krijohet një radhitje sipas kualitetit dhe gjatësisë së rrotullimit.

P.sh.

1. Pëllumbi me 2 fluturime dhe me rezultat 2 x 110
 2. Pëllumbi me 1 fluturim dhe me rezultat 1 x 110
 3. Pëllumbi me 3 fluturime dhe me rezultat 1 x 95, 1 x 105, 1 x 75
- d) Të gjithë kultivuesit apo garuesit kanë të drejtë t'i shfrytëzojnë 3 fluturimet nëse ata e shohin të arsyeshme.
 - e) Pëllumbat të cilët kanë shfrytëzua tre fluturime gjatë tërë sezonës së garave dhe janë të njëjtë në të gjitha cilësitë e kualitetit të treguar dhe gjatësisë së rrotullimit, të cilët nuk kanë manifestuar asnjë mangësi gjatë garave, konsiderohen të barabartë.

Në raste të tilla për të vendosur se cilit pëllumb i takon vendi i parë atëherë merret për bazë kualiteti i treguar gjatë tërë kohës së sezonës së garave dhe numrit të pjesëmarrjes në gara.

1. Lajmërimi për Garë Plus 50m

- a. Pëllumbat të cilët gjatë garës nuk arrijnë gjatësinë e kërkuar të rrotullimit 80 - 119 m, ndërsa kultivuesit ose garuesit e pëllumbave mendojnë se pëllumbat e tyre mund të kenë gjatësi më të madhe rrotullimi, atëherë ata mund të fluturojnë edhe një herë, por që gjatësia e rrotullimit herën e dytë i shtohet edhe për 50 m.



DARDANIA



SHOQATA E PËLLUMBAVE AKROBATIKË TË KOSOVËS NË ZVICËR

- b. Kultivuesit apo garuesit e pëllumbave të cilët gjatë garës arrijnë gjatësinë e rrotullimit mbi 120 m dhe duan të provojnë pëllumbin e tyre, atëherë pëllumbi i tyre gjatë fluturimit të dytë duhet të arrijë një gjatësi rrotullimi edhe për 35 m më gjatë.

2. Pëllumbat garues të cilët gjatë rrotullimit përplasen për tokë

- a. Pëllumbat të cilët gjatë rrotullimit nuk e arrijnë gjatësinë e rrotullimit mbi 80 m dhe i bien tokës nuk iu takojnë 10m plus (80 m deri 119 m i ka 10 m plus)
- b. Pëllumbat të cilët gjatë garave arrijnë që të kapin një gjatësi të rrotullimit mbi 120 m dhe i bien tokës duke u rrotulluar, atyre pëllumbave u takojnë dhe 15 m plus.
- c. Pëllumbat së pari vlerësohen krejtësisht normal dhe më pastaj u jepen edhe metrat plus si shpërblim (mbi 80m Plus 10m dhe mbi 120m Plus 15m)

13. Pëllumbi i blerë ose i huazuar

- a) Një kultivuesi ose garuesi i lejohet të merr pjesë në gara me pëllumbin të cilin ai e ka blerë ose huazuar. Por një kultivues ose garues i tillë është i detyruar ta njoftojë shoqatën për pjesëmarrje në gara 2 muaj më parë dhe më së voni 2 javë para mbajtjes së garave.
- b) Pëllumbave nuk u lejohet të garojnë në të njëjtën kohë për dy klube.
- c) Nëse një pëllumbi i ndërrohet kultivuesi ose klubi, atëherë ai ka të drejtë të marrë pjesë në gara edhe për klubin tjetër dhe njëkohësisht i pranohet vlerësimi i mëparshëm. Kultivuesit të ri të një pëllumbi të tillë i lejohet të marrë pjesë në gara edhe për fluturimet e mbetura.
- d) Pëllumbave iu pranohet dhe vlerësohet gara paraprake pa marrë parasysh se ku ka garuar aj pëllumb.
- e) Pëllumbi duhet të ketë dëftesën e lëshuar nga federata e pëllumbave të Kosovës.
- f) Pëllumbave me prejardhje të dyshimtë u ndalohet pjesëmarrja në gara. Një pëllumb i tillë mund të largohet edhe gjatë garës nëse heton gjë kryesia e shoqatës, duke marrë edhe masa ndëshkuese ndaj një kultivuesi apo garuesi të tillë.

14. Të metat e pëllumbave gjatë rrotullimit

- a) Pëllumbave u lejohet gjatë rrotullimit të bëjnë disa luhatje por që nuk dalin nga rrethi.
- b) Pëllumbave u lejohet të tentojnë të dalin nga rrethi ose të ndërpresin rrotullimin gjatë rrotullimit deri në mbarim.
- c) Pëllumbave iu lejohen vetëm tre shenja të të metave të rrotullimit, shenja të cilat nuk duhet të dallohen shumë.
- d) Pëllumbat të cilët gjatë rrotullimit paraqesin shenja tentimdalje nga rrethi ose kërcim dhe që e venë në dyshim rrethin e rrotullimit por që nuk ia dalin të arrijnë 50 m rrotullim ata nuk e kalojnë garën.
- e) Pëllumbat të cilët i bëjnë katër kërcime dhe nuk e arrijnë ndonjë nga gjatësitë e kërkuara të rrotullimit nuk e kalojnë garën.



DARDANIA



SHOQATA E PËLLUMBAVE AKROBATIKË TË KOSOVËS NË ZVICËR

Kërcimi dhe dalja nga rrethi

- f) Vlerësuesit apo gjyqtarët duhet të regjistrojnë patjetër kërcimin e pëllumbave me germën (**K**) në fletën për vlerësim, kurse daljen nga rrethi me germën (**D**) nuk ka ndonjë arsye për ta regjistruar.
- g) Regjistrimi i pëllumbave që bëjnë kërcim gjatë rrotullimit mund të na ndihmojë në renditjen e pëllumbave në rang listë. P.sh. pëllumbi me rrotullim 60 m (**1K**), 60 m (**2K**), 60 m (**3K**) dhe 60 m (**4K**)

Rang listat

1. Pëllumbi me Rrotullim 80m
2. Pëllumbi me Rrotullim (80m dhe 1K)
3. Pëllumbi me Rrotullim (80m dhe 2K)
4. Pëllumbi me Rrotullim (80m dhe 3K)
5. Pëllumbi me Rrotullim (80m dhe 4K)

15. Disiplina dhe sjellja në shoqatë

- a) Të gjithë anëtarët e kryesisë, anëtarët e thjeshtë dhe simpatizantët janë të detyruar që të jenë të sjellshëm dhe korrekt në shoqatë.
- b) Ndaj personave të cilët nuk sillen konform rregullave në shoqatë dhe pengojnë shoqatën në të gjitha fushat e saj do të mirren masa disiplinore.
- c) Ndaj personave të cilët nuk sillen konform rregullave në shoqatë fillimisht u tërhiqet vërejtja gojarisht dhe pastaj me shkrim. Përfundimisht largohet nga shoqata nëse rasti është ma serioz.
- d) Kryesia ka të drejtë ta suspendojë kultivuesin apo garuesin nga gara për 3, 7 ose 15 muaj. Në raste të veçanta garuesi apo kultivuesi mund të largohet nga gara dhe me afat të pa caktuar.
- f) Edhe anëtarët e larguar përkohësisht nga gara ka për detyrë ta bëjë pagesën e anëtarësisë.

16. Anëtarët e thjeshtë të shoqatës

- a. Kultivuesit kanë të drejtë t'i zgjedhin 3 anëtarë të pavarur. Këta tre veta kanë për detyrë t'i mbrojnë interesat e kultivuesve dhe të pëllumbave në rast se atyre u bëhet ndonjë e padrejtë.
- b. Anëtarët e rregullt të SHPAKZ duhet të kenë njohuri të përgjithshme për pëllumbat dhe t'i njohin mirë rrotullimet e pëllumbave.
- c. Njëri nga këta tre personat duhet t'i vëzhgojë gjithnjë garat. Kultivuesi e ka për detyrë t'i njoftojë këta persona për vendin dhe kohën e mbajtjes së garave.
- d. Shoqata e ka për detyrë t'i marrë parasysh edhe mendimet e tyre. SHPAKZ nuk i detyron këta persona t'i vëzhgojnë garat. Por nëse ata nuk janë prezent gjatë garave atëherë mendimi dhe ankesa e tyre nuk merret parasysh.

Hartuesi i Statutit dhe Rregullores së SHPAKZ "DARDANIA"
Rushit Rushiti / Copyright ®
Emmen / LU




DARDANIA



SHOQATA E PËLLUMBAVE AKROBATIKË TË KOSOVËS NË ZVICËR

SKEMA E CILA PËRCAKTON ZONËN DERI SA METRA LARG KOTECIT LEJOHET TË BËJË RROTULLIMIN NJË PËLLUMB



Shtëpiza (ose kafazi) i pëllumbave.



Rrethi me ngjyrë të kaltër ka 15 m larg nga zona e blertë dhe është zonë tolerance.



Rrethi me ngjyrë të verdhë është zonë e kufizuar në 60 m larg kotecit, ku vija diagonale nuk llogaritet.



Rrethi me ngjyrë të kuqe është zonë e ndaluar ku pëllumbi nuk lejohet të bëjë rrotullim.



Rrethi me ngjyrë të blertë është zonë e kufizuar në 155 m larg kafazit dhe pëllumbit i lejohet të bëjë rrotullim dhe vija diagonale llogaritet.